



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:232507

Datë: 10.09.2024

Numri i dokumentit: 06144397

C.nr.457/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.K, , kundër të paditurave L.M, me vendbanim të fundit në M. A.M, me vendbanim të fundit në P dhe S.M, me vendbanim të fundit në P, me objekt kontesti vërtetim pronësie, më datë 10.09.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I.** NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike kontestimore sipas padisë C.nr.457/2018, të datës 09.10.2018, për shkak të vdekjes së të paditurave L.M, A.M dhe S.M .
- II.** Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurave e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës paditëse.

**A r s y e t i m**

Paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 09.10.2018, kundër të paditurave me objekt kontesti vërtetim pronësie.

Gjykata me Aktvendimin e datës 29.04.2024, i ka detyruar të paditurat L.M, A.M dhe S.M që të paraqesin në gjykatë përgjigje në padi, mirpo nga tri fletëkthesat e Postës të pranuar në gjykatë me datë 10.05.2024, është konstatuar për secilën nga të paditurat se të njëjtat kanë vdekur.

Në mënyrë që gjykata të siguroj të dhënat zyrtare për konstatimin e vdekjes së të paditurave, ka kërkuar informacione nga Agjencia e Regjistrimit Civil të Kosovës, e cila Agjenci, me

parashtrësën nr.02/944, të datës 25.07.2024, ka konstatuar se të paditurat e kanë statusin “e vdekur”, ndërsa gjykata me datë 15.08.2024, ka kërkuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Vushtrri, certifikatat e vdekjes së të paditurave, të cilat nga kjo zyre i janë dërguar gjykatës në formë elektronike.

Sipas certifikatës së vdekjes së të paditurës L.M, me nr. serik: V 10704716, vërtetohet se e paditura L.M, ka vdekur me datë 27.11.2004, në Mitrovicë, sipas certifikatës së vdekjes për të paditurën A.M, nr. serik: V 10704717, vërtetohet se e njejta ka vdekur me datë 24.03.2012 në Prelluzhë, si dhe sipas certifikatës së vdekjes për të paditurën S.M me nr. serik: V 10704718, vërtetohet se e paditura S.M ka vdekur me datë 28.12.1992 në Prishtinë.

Prandaj gjykata konform nenit 277 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), sipas të cilës thuhet: “*Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale*”, vendosi si në dispozitivin I të këtij aktvendimi sepse është vërtetuar se të paditurat kanë vdekur, kurse si në dispozitivin II, të tij vendosi duke u bazuar në nenin 280 par 1, të LPK-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2019:232507, C.nr.457/2018, me datë 10.09.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Leotrim Gashi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.